


7. VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR, SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS

(92) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerësoi qëndrueshmërinë e sektorit bankar përballë zhvillimeve të supozuara ekonomike dhe financiare, për periudhën 2018-2019. Rezultatet tregojnë se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm. Ndikimi i këtyre supozimeve në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit vë në dukje nevojën për kapital shtesë në disa prej bankave individuale, kryesisht në rastin e skenarit të rënduar ku dhe supozimet janë më ekstreme.

7.1 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË NDAJ GODITJEVE MAKROEKONOMIKE

(93) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, për periudhën 2018-2019. Vlerësimi i ndikimit të situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës. Ushtrimi kryhet duke u mbështetur në tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar. Dy skenarët e fundit kanë një probabilitet më të ulët ndodhjeje dhe supozime më ekstreme.



(94) Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive përgjatë gjithë harkut kohor të zhvillimit të ushtrimit të provës së rezistencës. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me norma pozitive rritjeje të kreditimit, mbështetur gjithashtu në përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit të kredisë, deri



në fund të vitit 2019. Ecuria e portofolit të kredive me probleme, bazuar në shlyerjet faktike dhe procesin e fshirjeve, supozohet të vijojë efektet pozitive në periudhën afatshkurtër. Në skenarin e moderuar supozohet sërish një rritje ekonomike pozitive për të dy vitet e ushtrimit, por me ritëm dukshëm më të ulët kundrejt skenarit bazë; ndërsa në skenarin e rënduar është supozuar rritje e ekonomisë për 2018 dhe tkurrje e saj për vitin 2019.

(95) Supozimeve për ecurinë ekonomike në skenarët e moderuar dhe të rënduar, iu janë bashkëngjitur edhe supozimet përkatëse për një nënçmim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritje të normave të interesit dhe një rënie e ritmit të kreditimit deri në tkurrje të tij. Këto zhvillime, rezultojnë në uljen e cilësisë së portofolit të kredisë, e cila përkeqësohet deri në fund të vitit 2019 me përkatësisht deri në 3.7 pikë përqindje (skenari i moderuar) dhe 4.4 pikë përqindje (skenari i rënduar) ndaj vlerave të skenarit bazë. Në tërësi, këto supozime ndikojnë negativisht treguesit e kapitalizimit të sektorit bankar.

(96) Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:


- a. **Në skenarin bazë**, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar paraqitet e qëndrueshme, duke shënuar vlerën prej 17.7% në fund të vitit 2019, kundrejt vlerës 17.9% që shënonte në fund të qershorit 2018. Ky zhvillim përputhet me ritmin e mirë të rritjes ekonomike, përmirësimin e rritjes së kredisë, përmirësimin e ndjeshëm të portofolit të kredive me probleme dhe ecurinë e favorshme të kursit të këmbimit. Edhe zhvillimet sipas grupeve bankare tregojnë nivele të mira të kapitalit, dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ;
- a. **Në skenarin e moderuar**, RMK-ja e sektorit bankar shënon një nivel prej 15.6% në fund të vitit 2018 dhe 14.4% në fund të vitit 2019. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një normë më të ulët rritjeje të aktivitetit ekonomik, ndalim të kreditimit, rritje të normave të interesit dhe nënçmim të monedhës vendase. Bazuar edhe në supozimet e mësipërme dhe rezultatet e përfuara, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali. Konkretisht, numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara deri në fund të vitit 2019 është katër dhe ato përbëjnë rreth 20% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë janë rreth 0.9 miliardë lekë, deri në fund të vitit 2019;
- b. **Në skenarin e rënduar**, RMK-ja e sektorit bankar bie më pranë nivelit 12% në fund të vitit 2018 dhe në 10.8% në fund të vitit 2019, ndikuar nga supozimet ndjeshëm më të rënuara që përfshin ky skenar. Numri i bankave që bie në nënkapitalizim rritet në dhjetë dhe këto banka zënë rreth 50% të aktiveve të sektorit. Zhvillimet makroekonomike ekstreme që përmban skenari, krahas rritjes negative të kreditimit të ekonomisë,



ndikojnë në përqendrimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë. Gjithashtu, ky skenar supozon edhe humbje në portofolin e titujve dhe rritje të ekspozimit ndaj rrezikut të tregut dhe atij operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë arrijnë në 16.5 miliardë lekë.

Për të shprehur vlerat e kërkuara të kapitalit shtesë në këndvështrimin e zhvillimeve aktuale të sektorit bankar, theksojmë se vlera mesatare e rritjes vjetore të kapitalit të paguar të sektorit bankar, gjatë periudhës 2008-2016, ishte rreth 9 miliardë lekë.

Grafik 7.2 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

